

BASHKIA KOLONJË
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Nr. prot
Data:21.05.2020

Për: NET-GROUP shpk

Adresa: NET-GROUP shpk, Tirane Paskuqan Lagjja Paskuqan 1, rruga Demokracia, ndertesa nr.1, prane Ahmati Petrol.

Procedura e prokurimit: “Kërkesë për Propozim”, “Shërbime”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-56817-04-26-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Shërbim Mbikqyrje Punimesh për objektin: Rikonstruksion i rrjetit të brëndshëm dhe të jashtëm të furnizimit me ujë të qytetit të Leskovikut**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. BOE	A R G I shpk	dhe	HMK - Consulting shpk
	<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>		<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>
	K62028003A		L57129604Q
	<i>numri i NIPT-it</i>		<i>numri i NIPT-it</i>
Vlera 2.771.190 (Dymilioneshtatëqindeshatatëdhjetënjëmijënjëqindenëntëdhjetë) lekë pa Tvsh.			

2.Operatori ekonomik GJEOKONSULT & CO SHPK	K91810005U
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>
Vlera e ofertës 2.656.461 (Dymilioneegjashtëqindpesdhjetëgjashtëmijëekatërqindegjashtë dhjetënjë) lekë pa Tvsh .	

3.Operatori ekonomik INSTITUTI DEKLIADA – ALB shpk	K71606006A
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>
Vlera e ofertës 2,777,251.41 (Dymilioneshtatëqindeshatatëdhjetëeshtatëmijëedyqindpesëdhjetëe një pikë dyzetë e një) lekë pa Tvsh.	

4. Operatori ekonomik NET-GROUP SHPK	L72023002P
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>
Vlera 2,759,429.22 (Dymilioneshtatëqindpesëdhjetëenëntëmijëekatërqindenjëzetë enëntë pikë njëzetë e dy) lekë pa Tvsh.	

5. Operatori ekonomik TOWER SHPK	L21717003H
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>
Vlera 2,768,400.54 (Dymilioneshtatëqindegjashtëdhjetëetëmijëekatërqind pikë pesëdhjetë e katër) lekë pa Tvsh.	

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik OE GJEOKONSULT & CO SHPK

Vlera e ofertës **2.656.461** (*Dymilioneegjashtëqindpesdhjetegjashtëmijëekatërqindegjashtë dhjetëenjë*) **lekë pa Tvsh** .

2. Operatori Ekonomik TOWER shpk

Vlera e ofertës **2,768,400.54** (*Dymilioneshtatëqindegjashtëdhjetëetëmijëekatërqind pikë pesëdhjetë e katër*) **lekë pa Tvsh** .

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik GJEOKONSULT & CO SHPK

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 , “ **Për Prokurimin Publik** ”, (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “**Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik**”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga operator ekonomik **GJEOKONSULT & CO SHPK** .

a.Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.4.6** Kapaciteti Teknik , kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë ofertën ekonomike si më poshtë :

Operatorët ekonomik në përgatitjen e ofertes së tyre duhet ti referohen VKM nr.354,datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, si dhe në mbështetje të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik datë 25.07.2017, Nr: 5585 Prot ”Rekomandim mbi mënyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354,datë 11.05.2016” “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të hedhur në sistemin elektronik konkretisht oferta ekonomike e paraqitur nga operatori ekonomik **GJEOKONSULT & CO SHPK** është nën vlerën minimale të lejuar.

Komisioni i vlerësimit të ofertave gjykon se **arsyetimi i ofertës** së paraqitur nga operatori ekonomik **GJEOKONSULT & CO SHPK**,mbi rrethanat e jashtëzakonshme nuk lidhet me gjendjen në të cilin ndodhet vëndi jonë mbi situatën COVID – 19,apo me mangësinë e punëve publike , faktin që keni numër të lartë stafi dhe vështirësitë që ju si operator ju po hasin mbi të cilën keni hartuar një ofertë të cilën e keni argumentuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Vlera e ofertuar nga operatori ekonomik nuk është në përputhje me vlerën minimale dhe maksimale e përlllogaritur nga komisioni i përlllogaritjes së fondit limit i ngritur për këtë qëllim.Vlera minimale dhe maksimale është përcaktuar bazuar në VKM nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, dhe rekomandimin e APP-së, dhe oferta e paraqitur është më e ulët se vlera minimale e përlllogaritur nga autoriteti kontraktor për realizimin e kësaj kontrate , cituar në **pikën 2.4.6** të kriterëve të veçanta të kualifikimit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Pra autoriteti kontraktor si organi përgjegjës për zhvillimin e procedurës së prokurimit ka përcaktuar që në publikimin e procedurës detaje për përcaktimin e fondit limit, termat e referencës dhe pika 2.4.6 pjesë e dokumentave standarte të tenderit të cilat vinë në përmbushje të legjislacionit përkatës në fuqi.

1. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” sipërcituar në nenin 1 të tij “Fusha e Veprimit” **parashikon shprehimisht se:**

Ky manual i tarifave vlen për llogaritjen e pagesave për të gjitha shërbimet e planifikimit, projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të kryera nga arkitektët dhe inxhinierët (porosimarrës) të financuara me fonde publike, të financuara me fonde publike, të përfshira në listën e punimeve të këtij manuali.

Ndërsa në nenin 7 të saj parashikohet shprehimisht se:

Tarifat për shërbimet duhet të jenë në një vlerë ndërmjet tarifave minimale dhe maksimale të përcaktuara në këtë manual në përputhje me LPP.

Pika 3 e nenit 7 parashikon se:

Në rrethana të jashtëzakonshme dhe nëse dokumentohet me shkrim tarifat edhe mund të jenë më të ulëta se sa taifa minimale të specifikuar nga ky manual.

Por në këtë vendim nuk jepen rrethanat e jashtëzakonshme të cilat janë pasur parasysh.

Rrethanë e jashtëzakonshme nuk nënkupton gjëngje e jashtëzakonshme në të cilin ndodhet vëndi ,apo veshtirësitë e operatorit ekonomik .Në lidhje me gjëndjen në të cilën ndodhet vëndi janë të gjithë operatorët ekonomik,gjithashtu dhe institucionet shtetërore dhe nëse do ti referoheshim këtij fakti mbi arsyetimin e ofertës tuaj do të ishim në kundërshtim me nenin **1 , pika 2 , gërma d “Objekti dhe qëllimi” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”,**i ndryshuar, ku thuhet: “Autoriteti kontraktor të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”.

Për sa më sipër theksojmë se dhe **vetë kërkesa e autoritetit kontraktor për realizimin e kësaj procedure** nuk është në kushtet e rrethanës së jashtëzakonshme apo e një nevoje ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara,kjo në mbështetje të nenit 33 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “ Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 36 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar .

2. Në Rekomandimin Nr. 5585 datë.25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354 datë.11.05.2016 " Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikeqyrje edhe kolaudim ", si dhe njoftimit Nr. Prot.13565 datë.06.11.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Terheqje Vemendje", ku kërkohet detyrimisht zbatimi i akteve ligjore, nënljgore dhe VKM 354 datë.11.05.2016 " Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikeqyrje edhe kolaudim " **parashikohet shprehimisht se:**

- *Për shërbimet e parashikuara në vendimin e sipërcituar (Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016), APP rekomandon që, krahas përlllogaritjes së fondit limit (i cili përlllogaritet nisur nga perqindja maksimale e lejuar), bëhet përlllogaritja e vlerës minimale të lejuar (e cila përlllogaritet nisur nga perqindja minimale e lejuar), në varësi të kategorisë dhe grupit tarifor , ku bën pjesë objekti i prokurimit.*
- **Në nenin 7, pika 3,** të vendimit të sipërcituar, parashikohet se: *"Në rrethana të jashtëzakonshme dhe nëse dokumentohet me shkrim, tarifat edhe mund të jenë më të ulëta sesa normat minimale, të specifikuar nga ky manual".*

Në këtë kontekst rekomandojmë që, në rastet kur nuk dokumentohet rrethana e jashtëzakonshme, autoritetet kontraktore gjatë vlerësimit të ofertave, duhet t'i referohen vlerës minimale të përlllogaritur për secilin rast, në bazë të parashikimeve në VKM Nr.354, datë.11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim".

- *Në paraqitjen e ofertave në këtë lloj procedure prokurimi, operatorët ekonomike duhet të mbajnë në konsideratë edhe vlerat minimale të përlllogaritura nga autoritetet kontraktore në zbatim të VKM Nr: 354, datë.11.05.2016 " Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim ".*

Qëllimi i VKM nr. 354, datë.11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje edhe kolaudim”, është që të mbrojë profesionet të cilat merren me planifikim territori, projektim, mbikëqyrje e kolaudim, pra lidhet me punën intelektuale që do të bëhet, duke dhënë një punë cilësore, por me një vlerë mbi minimumin e lejuar të përcaktuar me një vendim të posaçëm.

Komisioni i vlerësimit të ofertave gjykon se, vlerësimi i kësaj oferte është kryer duke mos aplikuar formulën për ofertën anomalisht të ulët referuar ligjit për prokurimin publik, por i është referuar vlerave minimale, pasi operatori ekonomik ka paraqitur një ofertë të papërgjegjshme dhe nën kufirin e përcaktuar nga legjislacioni i posaçëm në fuqi “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, e cila është e detyrueshme për të gjithë operatorët ekonomikë, pasi ky legjislacion nuk lë në diskrecionin e autoritetit kontraktor të pranojë argumenta për elementët e veçantë të ofertës ekonomike të operatorëve, përsa kohë që ajo është jashtë kufijve minimalë dhe maksimalë të tarifave.

Gjithashtu, referuar edhe frymës së legjislacionit të posaçëm në fuqi, në rast se nuk zbatohet kjo VKM e cila ka dalë për qëllim të posaçëm për të mbrojtur punën intelektuale që bëhet në fushën e këtyre shërbimeve, atëherë kjo VKM nuk ka më asnjë vlerë dhe do të humbiste qëllimin për të cilin ka dalë për zbatim, sepse vetëm nëse do të mbeteshim tek argumentimi i analizës së kostos nëse ajo do të rezultonte anomalisht e ulët, atëherë kjo analizë do të ishte shumë subjektive, aq më tepër kur autoriteti kontraktor mund të kërkonte sqarime nga operatorët ekonomikë, nëse pas aplikimit të formulës për ofertën anomalisht të ulët, mbi ofertat brenda kufijve ligjorë, do të rezultonte se një apo më shumë oferta janë anomalisht të ulta.

Referuar sa më sipër Komisioni i vlerësimit të ofertave gjykon se duke qenë se kuadri ligjor në fuqi ka vendosur tarifa minimale dhe maksimale për shërbimet e mbikëqyrjes dhe kolaudimit duhet të mbahen në konsideratë nga operatori ekonomik pjesmarrës në këtë procedure dhe është detyrë e operatorit ekonomikë të garantoj që oferta e paraqitur të jetë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, me qëllim garantimin e një kontrate të sukseshme. Në rastin në fjalë, operatori ekonomik ka ofertuar me një vlerë e cila rezulton të jetë nën vlerën minimale të lejuar të përlllogaritur nga autoriteti kontraktor për kryerjen e këtij shërbimi.

Gjithashtu , sqarojmë se, në arsyetimin e ofertës tuaj të ndarë në pesë elementë , gjykojmë se është bërë një argumentim i papërgjegjshëm, konkretisht në mënyrën e pagesës së stafit.

Referuar, kriterëve për kualifikim **pika 2.4.2** të vendosura nga autoriteti kontraktor mbi disponimin e personelit kryesor stafit teknik të nevojshëm për zbatimin e kontratës ku janë kërkuar **6** inxhinierë drejtues teknik dhe **1** inxhinier mjedisi si staf mbështetës **pika 2.4.4,** njëkohësisht dhe listës së stafit kryesor të deklaruar nga ju për zbatimin e kësaj kontrate arsyetojmë si mëposhtë:

1. Bazuar në deklaratat e paraqitura Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi, (Paga bruto gjithsej në lekë), rezulton se

paga totale mujore për 7 inxhinerët e deklaruar shkon në vlerën 300.000 lekë .

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin e vendosur nga autoriteti kontraktor është **12 (Dymbëdhjetë)** muaj kalendarik ,sipas pikës 2.9 seksioni 2 i DST.

Nisur nga llogaritjet aritmetike do të rezultonte se shpenzimet për stafin e deklaruar për gjithë periudhën e kryerjes së shërbimit do të shkojnë në vlerën 300.000 lekë/totali mujor x 12 muaj = **3.600.000 lekë**.

2. Nëse do ti referohemi VKM nr.809 datë.26.12.2018 “PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MINIMALE NË SHKALLË VENDI”, ku paga minimale është **26.000 lekë në muaj** dhe ju si operator ekonomik do ti paguani mbi këtë pagë e cila është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vëndas ose i huaj,sipas pikës 1 të VKM të sipërcituar,shpenzimet për gjithë periudhën e kryerjes së shërbimit do të shkojnë në vlerën 7 x 26.000 lekë/ muaj x 12 muaj = **2.184.000 lekë**.

Për sa mësipër ,në të dyja rastet e llogaritjes së vlerës mbi shpenzimet e stafit të deklaruar rezulton në mospërputhje me arsyetimin e ofertës tuaj dhe komisioni gjykon se është bërë një argumentim i papërgjegjshëm i ofertës ekonomike.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 46, pika 1,nenit 53, të Ligjit Nr.9643,datë 20.11.2006,“Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu VII, Neni 66 pika 3 dhe VKM 354 date 11.05.2016 "Per miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Terriori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim" e shpall **të pavlefshme** ofertën e operatorit ekonomik .

2.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik **TOWER shpk**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 , “ **Për Prokurimin Publik** ”, (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Neni 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “**Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik**”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga operator ekonomik **TOWER shpk** .

a.Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.4.4**,Kapaciteti Teknik , profesional kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

2.4.4 Ofertuesi duhet të ketë pjesë të stafit 1 (një) Inxhinier Mjedis i çertifikuar për hartimin e raporteve të ndikimit në mjedis për të kryer auditimin mjedisor.

Për të cilin të paraqiten :

- *Diploma*
- *Çertifikatë për ushtrim profesional nga Ministria e Mjedisit*
- *Kontrata e punës dhe të figurojë në listëpagesat për periudhën (Tetor 2019 – Mars 2020).*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të hedhur në sistemin elektronik nga operatori ekonomik **TOWER shpk** është konstatuar se nuk ka paraqitur dokumentacion kualifikues për **1 (një) Inxhinier Mjedis** sipas kërkesës **pika 2.4.4** të kapaciteti teknik.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 46, pika 1, nenit 53, të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme ofertën e operatorit ekonomik **TOWER shpk** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE NET-GROUP shpk** me nius **L72023002P** dhe me adresë: *Tirane Paskuqan Lagjja Paskuqan 1, rruga Demokracia, ndertesa nr.1, prane Ahmati Petrol*, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **2,759,429.22** (Dymilioneshtatëqindpesëdhjetëenëntëmijëekatërqindnjëzetë enëntë pikë njëzetë e dy) **lekë pa Tvsh**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë

Emri	Bashkisë Kolonjë
Adresa	Sheshi “ Rilindja ”
Tel/Fax	+355 812 2 2225 ; +355 812 2 3173
E-mail	bashkia.kolonje@gmail.com

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi, por jo me vone se **5 (pesë) ditë** nga marrja e kërkesës me shkrim për lidhjen e kontratës.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në **datë :13.05.2020**

Ankesa: **JO**

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Erion ISAI